UNIVERSITETI I MITROVICËS
'ISA BOLETINI'

Modeli i Programit mësimor të lëndës (Syllabusi)		
Fakulteti:	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	
Departamenti:	Inxhinieri dhe teknologji ushqimore	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:	202. ITU.I	
Lënda:	Mikrobiologji e përgjithshme	
Statusi i lëndës:		Obligative
Semestri:		Veror
Fondi i orëve:		3+2
ECTS:		7
Orari/Salla	13.00 -15:15 / 103	
Viti akademik:	Viti i II-të, semestri i III-të	
Mësimdhënës/e:	Prof. Ass. Dr. Mirsade Osmani	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
Email:	mirsade.osmani@umib.net	?
Telefon:	+38349600851	?

PERMBAJTJE	Mikrobiologjia është një lëndë bazë që merret me studimin e mikroorganizmave, ndërtimin, funksionimin dhe ndikimin e tyre në organizmat e tjera të gjalla. Mikroorganizmat janë organizma të vogla mikroskopike njëqelizore të padukshme për syrin e njeriut dhe shumëqelizore. Këtu përfshihen bakteret, protozoat, kërpudhat, mikroalgat, prokariotët, viret. Kjo lëndë katë bëjë me morfologjinë e mikroorganizmave, ekologjinë (ndikimin e faktorëve abiotikë dhe biotikë në mikroorganizma), fiziologjinë (shkëmbimini materies ndër mikroorganizma), gjenetikën (trashëgiminë dhe ndryshushmëritë ndër mikroorganizma), njohjen me disa veqori të mikroorganizmave patogjen, si dhe me rolin që kanë mikroorganizmat për jetën e njeriut.
QËLLIMI	Në përfundim të programit, përmes ligjëratave, studentëttë arrijnë të kenë njohuritë bazë, në lidhje me biologjinë e qelizave prokariote, metabolizmin dhe diversitetin e ti ndër mikroorganizmat, gjenetikën mikrobike, sistematikën dhe evolucionin, etj. , t'i përforcojë ato përmes punës laboratorike eksperimentale, zgjidhjes së detyrave, në mënyrë që jo vetë të mësoj por të bëjë studim të objektivit të lëndës.

<table>
<tr><td>ARRITSHMËRIA</td><td colspan="2">Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studentët do të jenë në gjendje të:
1. Përshkruajnë morfologjinë e mikroorganizmave (formën, madhësinë strukturën e mikroorganizmave).
2. Njohin teknikën e kultivimit, si dhe t’i kultivojnë mikroorganizmat në ushqimore artificiale.
3. Definojnë rolin e faktorëve ekologjikë ne jetën e mikroorganizmave.
4. Njohin proceset e shkëmbimit të materies ndër mikroorganizma (Disimilimet aerobe dhe anaerobe).
5. Diskutojnë për vetitë trashëguese të mikroorganizmave.
6. Përshkruajnë disa veti të mikroorganizmave patogjenë.
7. Analizojnë rolin që kanë mikroorganizmat në jetën e njeriut.</td></tr>
<tr><td rowspan="15">PROGRAMI</td><td>Javët</td><td>Tema</td></tr>
<tr><td>Java - I</td><td>Definicioni, lënda e studimit, historiku i shkurtër i zhvillimit, pozita dhe roli i mikrobiologjisë.</td></tr>
<tr><td>Java - II</td><td>Forma dhe ndërtimi i viruseve, rikecieve dhe Chlamidieve (Bedsonieve).</td></tr>
<tr><td>Java - III</td><td>Forma, madhësia, struktura dhe funskioni i qelizës prokariote (Archaeave dhe Baktereve).</td></tr>
<tr><td>Java - IV</td><td>Vazhdim: Muri qelizor, membrana qelizore, mezozomet, analogët e mitokondrieve, analogët e RE, analogët aparatit të Golxhit, analogët tilakoideve ndër qelizat prokariote.</td></tr>
<tr><td>Java - V</td><td>Citoplzma, ribozomet, nukleoidi, vakuolat, lizozomet, dhe granulat, flagjelët, fimbriet, sporet (endosporet) ndër qelizat prokariote.</td></tr>
<tr><td>Java - VI</td><td>Bakteret rrezore (Actinomicetes), Algat blu të blerta (Cianophyta), Kërpudhat (Majatë dhe Myqet); Ndërtimi i qelizës së tharmit, parashtazorët – karakteristikat e përgjithshme. Vlerësimi i parë intermediar.</td></tr>
<tr><td>Java - VII</td><td>Ekologjia e mikroorganizmave (ndikimi i faktorëve abiotikë dhe biotikë në mikroorganizma).</td></tr>
<tr><td>Java - VIII</td><td>Fiziologjia e mikroorganizmave; Përbërja kimike e mikroorganizmave, enzimet e mikroorganizmave.</td></tr>
<tr><td>Java - IX</td><td>Shkëmbimi i materies ndër mikroorganizma – Rrugët e zbërthimit të glukozës. Disimilimet anaerobe (fermentimet).</td></tr>
<tr><td>Java - X</td><td>Disimilimet aerobe, disimilimet specifike, mekanizmi i frymëmarrjes së mikroorganizmave.</td></tr>
<tr><td>Java - XI</td><td>Shkëmbimi konstruktiv ndër mikroorganizma. Rritja dhe shumëzimi i mikroorganizmave.</td></tr>
<tr><td>Java - XII</td><td>Trashëgimia e mikroorganizmave; Ndryshueshmëritë ndër mikroorganizma dhe</td></tr>
<tr><td>Java - XIII</td><td>Përhapja e mikroorganizmave në natyrë dhe roli i tyre në qarkullimin e materies.</td></tr>
<tr><td>Java - XIV</td><td>Disa veçori të disa mikroorganizmve patogjenë.</td></tr>
</table>

	Java - XV	Mikroorganizmat në shërbim të njeriut. Vlerësimi i dytë intermediar.
LITERATURA	Literatura themelore: 1. Plakolli M. 2001: Mikrobiologjia e përgjithëshme. Prishtinë Literatura plotësuese: 2. Madigan M. T., Martinko M. J., Parker J., 2012: Biology of Microorganisms Tortora, Funke, Case, 2012. 3. Microbiology: An Introduction, 10th Edition, Lerner K. L., Lerner B. W., 2008:World of Microbiology and Immunology.	
METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike, etj. Fokusi kryesor do të jetë zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit ndërveprues të cilat nxisin të menduarit konstruktiv përmes leximit dhe shkrimit, punës në grupe, diskutimit, të mësuarit përmes projekteve, zgjedhjes së problemeve, punës laboratorike dhe në terren si dhe prezantime audiovizuele me videoprojektor, grafoskop, CD etj. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndërvepruese profesor–student si dhe ai student -student.	

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime	2	15	30
Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	2	5	10
Kolokiume /seminare	2	5	10
Detyra të pavarura	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final	2	5	10
Projektet, prezantimet, etj	2	5	10
Totali			**175 orë= 7 ECTS**

VLERËSIMI	**Metodat e vlerësimit** Vlerësimi në % Testi i –I-rë, me shkrim ..... 40% Testi i – II-të, me shkrim ..... 40% Pjesmarrja aktive në ligjerta dhe ushtrime.. 10% Punime seminarike.....10% Povimi me shkrim .....100% **Shkallët e notave** : 50-me pak – nota 5 (pesë) 52-61 % - nota 6 (gjashtë) 62-71 % - nota 7 (shtatë) 72-81 % - nota 8 (tetë) 82-91 % - nota 9 (nëntë) 92-100 % - nota 10 (dhjetë)
POLITIKAT AKADEMIKE	Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera te universitetit. Kodi i mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.

Mitrovicë

_____/_____/____

Bartës/e i/e lëndës:

Prof. Ass. Dr. Mirsade Osmani

_____

(Emër Mbiemër)

_____

(Nënshkrimi)